



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 255/5 prot.

Tiranë, më 20.6.2023

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 660, datë 16.5.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin znj. Majlinda Andrea
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 5.6.2023, është njoftuar vendimi nr. 660, datë 16.5.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin znj. Majlinda Andrea, ish-gjyqtare në Gjykatën e Lartë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor, nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 660, datë 16.5.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti, znj. Majlinda Andrea, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, mbante detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Lartë dhe

në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Për qëllim të procesit të rivlerësimit, Komisioni ka zhvilluar korrespondencë dhe ka administruar dokumentacion nga organe kushtetuese, të cilat kishin dijeni lidhur me rrethana ligjore dhe faktike të lidhura me statusin e znj. Majlinda Andrea dhe, më konkretisht, si vijon:

2.1 Gjykata e Lartë, me shkresën nr.***/** prot., datë 14.1.2022, ka vënë në dispozicion sipas kërkesës së Komisionit, vendimin gjyqësor të formës së prerë nr. ***/**, datë **.6.2017, me kërkesë Prokuroria e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë, të pandehur Majlinda Andrea etj.

2.2 Këshilli i Lartë Gjyqësor, me shkresën nr.***/** prot, datë 18.1.2022, pasi citon dispozitivin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. ***/**, datë **.6.2017, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, bën me dije se Këshilli i Lartë Gjyqësor ka zhvilluar mbledhjen e parë më datë **.12.2018 dhe nuk ka asnjë vendimmarrje lidhur me mbarimin e statusit të magjistratit për këtë subjekt. Gjithashtu, me shkresën nr. ***, datë 18.11.2022, i njëjti institucion, KLGJ-ja, i përgjigjet Komisionit, duke bërë një përshkrim kronologjik të korrespondencës së mbajtur ndërmjet Gjykatës së Lartë, ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Ministrisë të Drejtësisë dhe institucionit të Presidentit të Republikës, bashkëlidhur praktika dokumentare në kopje të njësuar. Në përmbajtje të shkresës, ky institucion bën me dije se nuk rezulton asnjë vendimmarrje nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe as nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për mbarimin e statusit të magjistratit, znj. Majlinda Andrea.

2.3 Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me shkresën nr.***/** prot., datë 24.1.2022, i përgjigjet Komisionit se, bazuar në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, deri më datën 21.1.2022, nuk rezulton të ketë nisur hetim disiplinor pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për marrjen e masës: “Shkarkim nga detyra”, ndaj magjistrates Majlinda Andrea.

2.4 Komisioni, në funksion të hetimit dhe vlerësimit të fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, ka evidentuar sa vijon: [...] (i) subjekti në momentin e hyrjes në fuqi të këtyre akteve ka qenë e pezulluar nga detyra e gjyqtarës së Gjykatës së Lartë, për shkak të procedimit penal që po zhvillohej ndaj saj. Pra, pezullimi i saj, për shkak të një procesi penal të filluar, nuk e përjashton atë nga qenia subjekt i ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, për Komisionin qëndron detyrimi i kryerjes së procesit dhe rivlerësimit të saj konform kuadrit ligjor në fuqi; (ii) subjekti i rivlerësimit, znj. Majlinda Andrea, është marrë si e pandehur me kërkesën e Prokurorisë së Krimeve të Rënda, më datë **.10.2016; (iii) me vendimin penal nr.**, datë **.6.2017, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, është deklaruar fajtorë për veprën penale “korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë” dhe, në zbatim të nenit 319/ç, të Kodit Penal, është dënuar me 4 vjet burgim. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim për një afat prove prej 3 vjetësh. Urdhërohet e dënuara Majlinda Andrea që të mbajë kontakte me shërbimin e provës, në bazë të nenit 60 të Kodit Penal. Në zbatim të nenit 35/1 të Kodit Penal të caktohet si dënim plotësues, heqja e së drejtës për të kryer funksione publike për një afat prej 5 vjetësh; (iv) duke vlerësuar se subjekti i rivlerësimit rezultoi i dënuar me vendim të formës së prerë për veprën penale “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të

organeve të drejtësisë”, në mungesë të një vendimi të organeve kompetente të kohës, ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe atyre sot, Këshilli i Lartë Gjyqësor, çmon se duhet të kryejë procesin e rivlerësimit [...].

2.5 Komisioni, referuar aktit: *Rezultatet e hetimit kryesisht*, i ka kaluar subjektit barrën e provës bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, pasi në analizë të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili e ka dënuar atë për veprën penale: *“Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”*, subjekti ka cenuar rëndë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

2.6 Subjekti, znj. Majlinda Andrea, paraqiti para Komisionit parashtrimet e saj, ndër të tjera, se Komisioni, në rastin konkret, nuk ka kompetencë të kryejë procesin e rivlerësimit ndaj saj dhe, për këtë arsye, ndërhyrja është e paparashikuar në ligj. Në vijim, subjekti parashtron se Komisioni duhet të vendosë për procesin e saj, mbështetur në trajtimin e statusit të subjektit, dhe përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar, pa një vendim përfundimtar, bazuar në nenin 95 të Kodit të Procedurës Administrative, si zgjidhjen e duhur dhe të drejtë ligjore.

3. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni, në vlerësim të situatës ligjore, në përputhje me nenin 104 të ligjit nr. 94/2016¹, duke qenë se subjekti është dënuar për kryerjen e një veprë penale të rëndë, vlerëson se gjendet në kushtet e cenimit të rëndë të besimit të publikut, në këndvështrim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, duhet të marrë masën e shkarkimit ndaj subjektit të rivlerësimit dhe, në zbatim të nenit 61, *“Shkarkimi nga detyra”*, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e këtij ligji, ka vendosur: [...] *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Majlinda Andrea, ish-gjyqtare e Gjykatës së Lartë [...].*

II. Vlerësimi i Komisionerit Publik

4. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

5. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit kontrollues/rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

6. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë

¹ Duket se është lapsus në referim nga Komisioni, pasi përmbajtja e nenit 104 është ajo e ligjit nr. 96/2016, i pandryshuar, citojmë: *“Shkelje disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale janë: a) faktet e pranuar nga gjykata, për të cilat magjistrati është deklaruar fajtor me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje, për të cilat ligji parashikon dënim me burgim ose me gjobë; b) faktet e pranuar nga gjykata, për të cilat magjistrati është deklaruar fajtor dhe dënuar me burgim me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale nga pakujdesia; c) faktet e pranuar nga gjykata, për të cilat magjistrati është dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale të ndryshme nga ato të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të këtij neni, nëse për vetë natyrën e faktit penal të konsumuar është diskredituar rëndë figura, autoriteti, dinjiteti, si dhe është dëmtuar rëndë besimi i publikut”*.

vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

7. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave të administruara.

8. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, pasi shqyrtoi dhe vlerësoi vendimin nr. 660/2023 dhe aktet shoqëruese të tij, çmon se vendimi është i cenueshëm dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Lidhur me rrethanat ligjore e të faktit, sikurse do të trajtohen edhe në vijim, Komisioneri Publik i referohet edhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, si organi i vetëm gjyqësor që vendos për vlerësimin përfundimtar në këtë proces.

9. Në përfundim të sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 2 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ushtron të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. 660/2023 të Komisionit.

III. Analiza e shkaqeve të ankimit

10. Referuar përmbajtjes dhe arsytimit të vendimit nr. 660, datë 16.5.2023, Komisioneri Publik vlerëson të konsiderojë nëse vendimi i Komisionit është marrë në vlerësim të drejtë të situatës faktike e zbatim të drejtë të kuadrit kushtetues dhe ligjor dhe në vijim si duhet të vepron organet e rivlerësimit për këtë situatë faktike dhe kuadër kushtetues e ligjor.

11. Nga aktet në dosje të Komisionit, rezulton sa vijon:

11.1 Znj. Majlinda Andrea, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", dhe ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ka qenë anëtare e Gjykatës së Lartë, subjekt rivlerësimi për t'iu nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, sipas pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

11.2 Me vendimin gjyqësor të formës së prerë nr. ***/**, datë **.6.2017, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, është vendosur përfundimisht: [...] *deklarimi fajtor i të pandehurës Majlinda Andrea për veprën penale të "Korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë"* dhe, në zbatim të nenit 319/ç, të Kodit Penal, dënimin e saj me 4 vjet burgim...në zbatim të nenit 59 të KP-së urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim për një afat prove prej 3 vjetësh. Urdhërohet e dënuara Majlinda Andrea që të mbajë kontakt me shërbimin e provës në bazë të nenit 60 të KP-së. Në zbatim të nenit 35/1 të KP-së, të caktohet si dënim plotësues "heqja e së drejtës për të kryer funksione publike për një afat prej 5 vjetësh [...].

11.3 Me vendimin nr.***, datë **.4.2018, Gjykata Kushtetuese, pasi ka shqyrtuar në seancë plenare çështjen më kërkuese Majlinda Andrea, me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me

Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. ***/**, datë **.6.2017, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ka vendosur rrëzimin e kërkesës (*botuar në FZ, nr. 60/2018*).

11.4 Ndërkohë, me dhënien e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. ***/**, datë **.6.2017, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Kryetari i Gjykatës së Lartë, me shkresën nr. *** prot., datë **.6.2017, i është drejtuar Presidentit të Republikës, në cilësinë e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Ministrit të Drejtësisë, duke kërkuar shkarkimin nga detyra të znj. Majlinda Andrea, me qëllim deklarimin e mbarimit të mandatit të saj si anëtare e Gjykatës së Lartë.

11.5 Kryetari i Gjykatës së Lartë, referuar nenit 139 të Kushtetutës, në interpretim të nenit 160/1/c, të ligjit nr. 96/2016, dhe vendimit nr. 34/2017 të Gjykatës Kushtetuese (*prg. 30*) ka identifikuar në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, Këshillin e Lartë të Drejtësisë, si organin i cili, deri në ngritjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor, me propozim të Ministrit të Drejtësisë, vendoste masat disiplinore për gjyqtarët sipas parashikimeve të ligjit.

11.6 Në kushtet kur dënimi i gjyqtarit me vendimin të formës së prerë për kryerjen e një krimi parashikohet drejtpërsëdrejti nga neni 140/2/b i Kushtetutës, si një ndër rastet kur gjyqtarit i jepet masa disiplinore: “*shkarkim nga detyra*”, vendimmarrja konstatuese nga ana e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në atë kohë, lejonte që mbarimi i mandatit si anëtare e znj. Majlinda Andrea, të deklarohej me vendim të Gjykatës së Lartë.

11.7 Konstatohet, sipas procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më datë **.7.2017, se Këshilli i Lartë i Drejtësisë, këtë kërkesë të paraqitur nga kryetari i Gjykatës së Lartë, ka vendosur, me shumicë votash, ta rrëzojë, duke interpretuar mungesën e lëndës dhe kompetencës, e duke votuar pro kësaj kërkesë, Presidenti i Republikës dhe një nga anëtarët gjyqtarë të këtij Këshilli.

11.8 Pas rrëzimit të kërkesës të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, nisur nga propozimi për të ndjekur *iterin* procedural të verifikimit të plotësimin të kriterëve të legjislacionit në fuqi për dekriminalizimin, është vijuar një praktikë administrative shkëmbimi aktesh mes Këshillit të Lartë të Drejtësisë, institucionit të Presidentit të Republikës dhe Prokurorisë së Përgjithshme, pa u finalizuar kjo në një vendimmarrje, lidhur me marrjen e masës disiplinore të parashikuar në Kushtetutë.

11.9 Duke konsideruar znj. Majlinda Andrea si një subjekt rivlerësimit, për efekt të juridiksionit kushtetues të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, rezulton se Komisioni ka kërkuar dhe marrë akte nga institucionet e ngarkuara nga Kushtetuta për kryerjen e procesit të zakonshëm disiplinor për magjistratët në Republikën e Shqipërisë.

11.10 Rezulton se nga kjo korrespondencë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me shkresën nr.***/**, datë **.1.2022, ka parashtruar se, nga mbledhja e parë pas konstituimit, nuk ka asnjë vendimmarrje lidhur me mbarimin e statusit të magjistratit për znj. Majlinda Andrea, në ushtrim të kompetencës kushtetuese, të parashikuar nga neni 147/a, paragrafi i parë, germa b.

11.11 Komisioni rezulton se i është drejtuar edhe institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si institucioni të cilin Kushtetuta në nenin 147/d, paragrafi i parë, e ngarkon me

përgjegjësinë për të filluar procedimin disiplinor në ngarkim të magjistratëve, bazuar në rastet e parashikuara në Kushtetutë, neni 140.

11.12 Me shkresën nr. ***/** prot., datë 24.1.2022, duke e konsideruar si *magjistrate* znj. Majlinda Andrea, institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka parashtruar se, bazuar në ligjin nr. 96/2016, deri më datë 21.1.2022, nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nuk rezulton të ketë nisur hetim disiplinor dhe nuk është paraqitur kërkesë për procedim disiplinor pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për marrjen e masës: “*shkarkim nga detyra*”, ndaj *magjistrates* Majlinda Andrea.

11.13 Komisioneri Publik, pas parashtrimit të kuadrit rregullator kushtetues dhe ligjor të rastit konkret, fillimisht nënvizon se ligjvënësit janë treguar të kujdesshëm që në ndryshimet kushtetuese, të cilat sanksionuan zbatimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, të parashikonin që institucionet e rivlerësimit, ushtrimin e kompetencës së tyre kushtetuese, ta kryenin në harmoni të plotë me institucionet e reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, të cilat, këto të fundit, nuk pengoheshin të përmbushnin detyrimet e tyre kushtetuese apo të ishin në kushtet e mbivendosjes së kompetencave, lidhur me procesin disiplinor ndaj magjistratëve në Republikën e Shqipërisë, gjatë ecurisë së mandatit të funksionimit të institucioneve të rivlerësimit.

11.14 Kështu, në nenin 179/b, paragrafi 7, Kushtetuta, shprehimisht, ka parashikuar se moskalimi me sukses i *procesit të rivlerësimit* përbën shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës nga ana e magjistratit, *krahas shkaqeve të parashikuara në Kushtetutë.*

11.15 Ky formulim i qartë i kësaj dispozite, u krijon mundësinë të dy juridiksioneve disiplinore, atij të jashtëzakonshëm (*institucioneve të rivlerësimit kalimtar*) dhe atij të zakonshëm (*Inspektor i Lartë i Drejtësisë, Këshilla*) të funksionojnë njëkohësisht në ushtrim të kompetencës përkatëse kushtetuese, më konkretisht në rastet e mbarimit të ushtrimit të detyrës, sipas legjislacionit specifik që, ndër të tjera, rregullon posaçërisht për secilin juridiksion, procedurat e procesit, shkaqet e mbarimit të ushtrimit të detyrës/shkarkimit, ushtrimin e të drejtës së ankimit dhe gjykatën që e shqyrton etj.

11.16 Nëse juridiksioni i jashtëzakonshëm disiplinor, shkaqet e mbarimit të detyrës i ka të parashikuara në dispozitat e aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, juridiksioni i zakonshëm disiplinor, ato i ka të parashikuara në nenin 140, 148/d të Kushtetutës dhe pjesën përkatëse të ligjit nr. 96/2016.

11.17 Në rastet e parashikuara nga neni 140/2/b dhe 148/d/2/b i Kushtetutës, veprimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për të kërkuar nga Këshillat marrjen e masës disiplinore për shkarkimin nga detyra të magjistratëve, sa kohë bazohet në ekzistencën e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, që ka dënuar magjistratin për kryerjen e një krimi, konstatohet se është një *iter* procedural automatik, që pasohet nga një vendimmarrje e formës konstatuese nga ana e Këshillave (*shihni vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.34/2017, prg. 58, lidhur me prg. 3.3.5.4.2*).

11.18 Kjo vendimmarrje konstatuese nga ana e Këshillave, në rastet e ekzistencës së një vendimi gjyqësor të formës së prerë, që dënon magjistratin për kryerjen e një krimi, është

qartësisht e ndryshme nga vendimmarrja vlerësuese në themel, në rastet e kërkesave të paraqitura nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas nenit 140/2/a dhe 148/d/2/a të Kushtetutës.

11.19 Në vijim të këtij argumenti, po t'i referohemi nenit 111 të ligjit nr. 96/2016, është lehtësisht e dallueshme se, teksa rendit shkaqet e dhënies së masës disiplinore: “*shkarkim nga detyra*”, ligjvënësi nuk i referohet shkakut të dhënies së kësaj mase disiplinore në rastet e ekzistencës së një vendimi gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e një krimi, sa kohë ky shkak parashikohet shprehimisht si i tillë dhe në mënyrë ezauruese në nenin 140/2/b e 148/d/2/a të Kushtetutës dhe nuk mund të përbëjë lëndë për diskrecionin vlerësues të Këshillave, sikundër përbëjnë shkaqet e parashikuara në nenin 140/2/a dhe nenin 148/d/2/a të Kushtetutës.

11.20 Krahasimisht, sa u trajtua më lart për juridiksionin e zakonshëm disiplinor, po aq edhe institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, brenda ushtrimit të kompetencës së tyre kushtetuese shprehen si me vendimmarrje që bazohet në shqyrtimin e themelit të çështjes së rivlerësimit për magjistratin, përkatësisht duke gjykuar mbi kriteret e pasurisë, profesionalizmit dhe figurës, ashtu edhe me vendimmarrje, që në thelb mbeten konstatuese të ekzistencës së një rrethane juridike, e cila sjell pasoja për ecurinë/ndërprerjen/përfundimin e procesit të rivlerësimit, të tilla si mbarimi i statusit të magjistratit me vendim të Këshillave për shkak të: (i) dorëheqjes, (ii) pensionimit për shkak të arritjes së moshës, (iii) marrjes së masës disiplinore të “*shkarkimit nga detyra*” etj.

11.21 Këto vendimmarrje të natyrës konstatuese nga ana e institucioneve të rivlerësimit, të dhëna në ushtrim dhe brenda kompetencës së tyre kushtetuese të kryerjes së procesit të rivlerësimit kalimtar, janë një praktikë vijuese e që, në raste të caktuara, kanë gjetur interpretim edhe në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si gjykata e procesit të rivlerësimit kalimtar.

11.22 Referuar rastit konkret në shqyrtim, Komisioneri Publik çmon të nevojshme të sjellë në vëmendje se vendimet e Kolegjit (JR) nr. 32/2021 dhe nr. 29/2021, tashmë kanë konsoliduar praktikën e Komisionit (vendimet nr. 493/2021, nr. 500/2022) se në rastet e dënimit të magjistratëve me një vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi, ushtrimi i kompetencës nga ana e institucioneve të rivlerësimit, për efekt të procesit të rivlerësimit duhet të konkludojë me një vendim konstatues të ndërprerjes pa vendim përfundimtar të procesit, për sa kohë juridiksioni i zakonshëm disiplinor (Inspektor i Lartë i Drejtësisë, *Këshilli përkatës*) ka ushtruar kompetencën e tij, ashtu sikundër e detyron Kushtetuta, duke mbaruar statusin e magjistratit për shkak të shkarkimit nga detyra.

11.23 Ndërkohë, në rastin konkret, duke e konsideruar ekzistencën e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, që ka dënuar znj. Majlinda Andrea për kryerjen e një krimi, si një shkak që kategorizohet sipas nenit 61/5 të ligjit nr. 86/2016 dhe passjell shkarkimin e saj nga detyra për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar, Komisioneri Publik konstaton, së pari, se Komisioni në interpretim të gabuar të Kushtetutës, neni 140/2/b, ka konsideruar se znj. Majlinda Andrea gëzon statusin e magjistratit, e për rrjedhojë, të subjektit të rivlerësimit kalimtar.

11.24 Së dyti, e për rrjedhojë, Komisioneri Publik vlerëson se Komisioni, në interpretim të gabuar të dispozitave të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, ekzistencën e rrethanës juridike të dënimit me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi, e ka

konsideruar si një shkak që lejon juridiksionin e jashtëzakonshëm disiplinor (*rivlerësimi kalimtar*) ta çmojë këtë rrethanë (*vendimin e formës së prerë të dënimit*), si një ndër rastet e shqyrtimit në themel të procedurës së rivlerësimit, duke e kategorizuar ekzistencën e saj, si një ndër rastet kur shkarkimi nga detyra i magjistratit kryhet bazuar në nenin 61/5 të ligjit nr. 84/2016, për shkak të cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

11.25 Ushtrimi nga ana e Komisionit i kompetencës kushtetuese së kryerjes së procesit të rivlerësimit, duke sjellë si pasojë marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të gjyqtarit, në kuadër të procesit të rivlerësimit, bazuar në dënimin e magjistratit me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi, nuk mund dhe nuk duhet të zëvendësojë ardhjen e pasojës kushtetuese (*shkarkimit nga detyra të gjyqtarit*), për shkak të mosveprimit të institucioneve të juridiksionit të zakonshëm disiplinor (*Inspektor i Lartë i Drejtësisë, Këshill i Lartë Gjyqësor*), të cilët Kushtetuta i detyron të veprojnë në rastin konkret, në përmbushje të kompetencës së tyre.

11.26 Brenda ushtrimit të kompetencës, që Kushtetuta i njeh institucioneve të rivlerësimit, Komisioni ka pasur mundësinë që të verifikonte dhe të hetonte, në vazhdimësi, shkaqet që kanë sjellë mosveprimin e institucioneve kushtetuese të juridiksionit të zakonshëm disiplinor, për të ushtruar kompetencën e tyre kushtetuese të kryerjes së hetimit dhe procedimit disiplinor, me qëllim marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të znj. Majlinda Andrea.

11.27 Ndodhur në këto rrethana kushtetuese, juridike dhe faktike, Komisioneri Publik çmon se juridiksioni kontrollues dhe rivlerësues i Kolegjit, do të duhet të ushtrohet për të hetuar se cilat eventualisht kanë qenë shkaqet e prezumuara ligjore, që kanë sjellë si pasojë mosveprimin nga ana e institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, e për pasojë, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në inicimin e hetimit dhe procedimit disiplinor ndaj një magjistrati, ndaj të cilit është dhënë një vendim i formës së prerë për kryerjen e një krimi.

11.28 Ky hetim është i nevojshëm për të verifikuar edhe nëse, eventualisht, për shkak të kohës së gjatë të kaluar, nga korrespondenca shkresore e Komisionit me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor, që daton janar 2022, me zhvillimin e seancës dëgjimore publike nga Komisioni, maj 2023, Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor të kenë ushtruar detyrimin e tyre kushtetues.

11.29 Në rast se, pas hetimit nga ana e Kolegjit, do të rezultojë se institucionet e juridiksionit të zakonshëm disiplinor kushtetues e kanë përmbushur detyrimin e tyre kushtetues dhe se është dhënë masa disiplinore: "*shkarkim nga detyra*", procesi i rivlerësimit për znj. Majlinda Andrea do të duhet të deklarohet i përfunduar, pa një vendim përfundimtar, ashtu sikundër jurisprudenca e Kolegjit urdhëron në vendimmarrjet përkatëse, të përmendura më lart në këtë ankim.

11.30 Në rast se, edhe gjatë hetimit të kryer nga ana e Kolegjit, për shkak të gjykimit të këtij ankimi, rezulton se institucionet që Kushtetuta i ngarkon me kompetencën e përmbushjes së juridiksionit të zakonshëm disiplinor kushtetues, janë ende në kushtet e mosveprimit, edhe për shkak të rolit kushtetues të parashikuar nga paragrafi 5, i nenit 179/b i Kushtetutës, zbatimi i drejtpërdrejt nga ana e Kolegjit i dispozitës së nenit 140/2/a të Kushtetutës, për efekt të kryerjes së procesit të rivlerësimit, do të duhet të sjellë të njëjtën pasojë, deklarimin e përfunduar të

procesit të rivlerësimit, pa një vendim përfundimtar për shkak të humbjes së statusit të magjistratit.

11.31 Komisioneri Publik, në referencë të paragrafit të dytë, të nenit C të aneksit të Kushtetutës, vlerëson se ushtrimi i kompetencës kushtetuese nga ana e institucioneve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe ligjore, është një detyrim që buron nga përmbajtja e paragrafit 1, të nenit 179/b, të Kushtetutës, duke reflektuar institucionet e rivlerësimit, ata vetë të parët, funksionimin e duhur të shtetit të së drejtës.

IV. Kërkimi i ankimit

12. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik në procesin e rivlerësimit, ka të drejtën dhe detyrimin e ushtrimit të kontrollit ndaj vendimeve të dhëna nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, duke vlerësuar nëse vendimmarrja bazohet në një hetim të plotë dhe të gjithanshëm dhe çmim të drejtë të ligjit dhe provave të administruara;

13. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt me Komisionin;

14. Mbështetur në parashikimin e nenit F, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, kërkojmë që shkaqet e parashtruara në këtë ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe për znj. Majlinda Andrea, në përfundim të gjykimit të çështjes, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 660, datë 16.5.2023, të Komisionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

- Të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Majlinda Andrea, pa një vendim përfundimtar, për shkak se subjekti ka humbur statusin e magjistratit.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA